



EHEAROME2020

Komunikata Ministore Romë

SHTOJCA III



EUROPEAN
Higher Education Area



bologna
process



ITALIAN **BFUG** SECRETARIAT
2018-2020



Translated within the Erasmus+ project “[IN-GLOBAL Enhancing Knowledge of the EHEA and Global Dialogue](#)” in 2023.

The original version of the Rome Communiqué and its annexes are available on the website of the European Higher Education Area:

<https://ehea.info/page-ministerial-conference-rome-2020>



**Co-funded by
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

Rekomandime për Autoritetet Kombëtare për Rritjen e Mësimit dhe Mësimdhënies në Arsimin e Lartë në ZEAL

Përgatitur nga Grupi Këshillues 2 i BFUG për të Nxënëit dhe Mësimdhënien

Në Komunikatën Ministrore të Parisit 2018, Ministrat njoftuan shtimin e "bashkëpunimit në të mësuarit inovativ dhe praktikatat e mësimdhënies si një tjetër shenjë dalluese e ZEAL".

Për këtë qëllim u propozohen Ministrave dhe autoriteteve kombëtare rekomandimet aktuale për veprim, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi dhe partneriteti brenda dhe ndërmjet sistemeve evropiane të arsimit të lartë.

Rekomandimet respektojnë plotësisht vlerat themelore të ZEAL, të shprehura së fundmi në Komunikatën e Parisit të datës 24-25 maj 2018 si vijon: "Liria dhe integriteti akademik, autonomia institucionale, pjesëmarrja e studentëve dhe personelit në qeverisjen e arsimit të lartë, dhe përgjegjësisë publike për dhe të arsimit të lartë formojnë shtyllën kurriore të ZEAL."

Konteksti i krizës shëndetësore Covid-19 nënvizon më tej rëndësinë e rekomandimeve të Grupit në disa aspekte. Veçanërisht të rëndësishme janë ato për nevojën për inovacion pedagogjik dhe zhvillimin e mëtejshëm të arsimit online dhe burimet e lira arsimore, si dhe atë të forcimit të lidhjes ndërmjet kërkimit arsimor dhe mësimdhënies.

Rekomandimet e përmbledhura më poshtë janë të strukturuar rreth nevojës për të mësuarit me në qendër studentin, përmirësimin e mësimdhënies, dhe rëndësinë e përgjithshme të dialogut kombëtar dhe ndërkombëtar që përfshin të gjithë palët e interesuara. Këto tre tema janë të ndërlidhura dhe po aq të rëndësishme.

Rekomandimet nënvizojnë gjithashtu rëndësinë thelbësore të përforsimit të instrumentave të Proçesit të Bolonjës, veçanërisht ECTS, për të treguar rezultatet e arritura të të nxënëit dhe ngarkesën e tyre të punës, si dhe angazhimet e tjera kyçe të Proçesit të Bolonjës. Autoritetet publike përgjegjëse për arsimin e lartë duhet të angazhohen:

1. Të bëjnë realitet të mësuarit me në qendër studentin, duke:

mbështetur institucionet e arsimit të lartë në përpjekjet e tyre për të filluar ose mbajtur një dialog të strukturuar mbi inovacionin dhe përmirësimin e të nxënëit dhe të mësimdhënies, duke përfshirë studentët, mësuesit dhe gjithashtu aktorët përkatës të jashtëm. Çështjet e trajtuara duhet të përfshijnë zhvillimin e kurrikulave, rezultatet e të nxënëit, vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, duke marrë parasysh aftësitë e nevojshme për të adresuar sfidat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë;

promovuar, brenda kurseve disiplinore, zhvillimin e aftësive të buta dhe aftësive të nevojshme për të qytetarët e arsimuar të shekullit të 21-të, për të kuptuar sfidat e një bote komplekse dhe për të respektuar të tjerët dhe mjedisin;

eksploruar mënyra për të stimuluar shkëmbimin ndërkufitar të praktikave të mira për të mbështetur përmirësimin e nxënies dhe mësimdhënies cilësore, duke vënë theksin në metodat aktive;

krijuar një mjedis mbështetës, si në aspektin financiar ashtu edhe në atë ligjor, që u mundëson institucioneve të arsimit të lartë të përshtatin ofrimin e arsimit për nevojat e natyrave/llojeve të ndryshme të studentëve (studentë gjatë gjithë jetës, studentë me kohë të pjesshme, studentë nga grupet e nënpërfaqësuar dhe të pafavorizuara), dhe për të ndërtuar një kulturë për barazi dhe përfshirje. Kjo përfshin krijimin e mënyrave fleksibël të të mësuarit (përfshirë mikro-kredencialet) në nivelet institucionale dhe kombëtare dhe në të gjithë

ZEAL, dhe për të eksploruar mundësitë e ofruara nga teknologjitë dixhitale për ta bërë këtë;

inkurajuar dhe mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare dhe institucionale dhe qasjet për Edukimin e Lirë/Hapur dhe përdorimin e Burimeve të Lira/Hapura Edukuese/Arsimore;

stimuluar mobilitetin e studentëve përtej marrëveshjeve të paracaktuara midis universiteteve.

2. Të nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke:

promovuar krijimin e ekipeve arsimore që përfshin akademikët dhe stafin përgjegjës për t'i ndihmuar ose trajnuar ata në misionin e tyre (ekipet institucionale dhe/ose ndërinstitucionale);

mbështetur institucionet e arsimit të lartë në rritjen e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) të mësuesve dhe shkëmbimin (ndërkufitar) të praktikave të mira. Masat ndërinstitucionale për zhvillimin e stafit dhe krijimi i strukturave kombëtare bashkëpunuese mund të konsiderohen si mënyra për të përmirësuar ZHVP;

mbështetur institucionet e arsimit të lartë në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe mbështetës në nivelet institucionale dhe kombëtare për transformimin, veçanërisht dixhital, të mësimdhënies dhe të nxënit cilësor. Një mjedis i tillë duhet të krijohet në bashkëpunim me stafin përgjegjës për mësimdhënien dhe të përfshijë një kornizë me kushte të mira pune dhe një ngarkesë mësimore të menaxhueshme, si dhe mundësi tërheqëse për kohëmbajtje/qëndrim;

siguruar masat strukturore, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë (të cilat duhet të përfshijnë të gjithë përgjegjësit për mësimdhënien), për të siguruar barazinë e vlerësimit për mësimdhënien dhe kërkimin. Nëse është e nevojshme, duhet të rishikohen skemat e karrierës akademike për të siguruar një njohje më të mirë të mësimdhënies në karrierën akademike;

eksploruar, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, mënyra për të nxitur mësimdhënien dhe metoda inovative, me fokus në qasjet ndër- dhe multidisiplinare, të nxënit dhe mësimdhënien e bazuar në kërkime, përdorimin e duhur të analitikës së të mësuarit dhe edukimit të hapur, mes qasjeve të tjera inovative.

3. Të forcojnë kapacitetin e institucioneve dhe sistemeve të arsimit të lartë në përmirësimin e të nxënit dhe mësimdhënien, duke:

përfshirë zgjerimin e të nxënit dhe të mësimdhënies në strategjitë dhe qasjet kombëtare të arsimit të lartë. Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe qasjeve të tilla duhet të shërbejë si bazë për një dialog të strukturuar dhe të vazhdueshëm me institucionet e arsimit të lartë dhe palët e tjera të interesuara në komunitetin e nxënies dhe mësimdhënies;

mbështetur zhvillimit strategjik dhe kapacitetet inovative të të nxënit dhe mësimdhënies si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë institucional, nëpërmjet kërkimeve empirike arsimore, projekteve dhe modeleve, si dhe mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave në lidhje me arsimin, duke respektuar privatësinë e të dhënave;

eksploruar mënyrat për të stimuluar dhe mbështetur shkëmbimin ndërkufitar të praktikave të mira në nivel kombëtar dhe në të gjithë ZEAL, për shembull me platforma për shkëmbim dhe bashkëpunim;

shpërndarë fondet dhe burimet e përshtatshme dhe të qëndrueshme, dhe miratimin e kornizave ligjore të përshtatshme për këtë qëllim kur është e nevojshme, për t'u mundësuar institucioneve të arsimit të lartë të zhvillojnë mësimdhënie inovative dhe cilësore si dhe mjedise mësimore.

Bologna Follow Up Group, në planin e tij të ardhshëm të punës, kërkohet të mbështesë zbatimin e rekomandimeve mbi të nxënët dhe mësimdhënien me synimin për të arritur progres të përbashkët në ZEAL dhe për të raportuar mbi rezultatet në kuadër të Raportit të Zbatimit të Procesit të Bolonjës në 2024.



**Co-funded by
the European Union**

This translation is co-funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

